




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

Drejtoria Komunale e Arsimit

Datë: 24.8.2023
Vendi: Rahovec
Nr. i ref.: 04/1117
Drejtori: Avni Morina




Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 8, i Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-032, të datës 29.8.2011, neni 34 dhe 35, të Ligjit për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-068, neni 5, paragrafi c, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, Nr. 05/2021, për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, shpall:

KONKURS

Për plotësimin e një (1) pozite të lirë të punës me kuadër profesional të arsimit, për vitin shkollor 2023/2024: **Mësimdhënës/e për lëndën e TIK-ut në:**

➤ **ShFMU "Isa Boletini"**

I. Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët/et për të marrë pjesë në konkurs:

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional sipas U.A. 05/2021, Udhëzimit Administrativ për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë.

II. Dokumentet e nevojshme:

- Kopjen e diplomës së fakultetit të kryer, të noterizuar;
- Kopjet e certifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë;
- Kopjen e ekstraktit të lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime.

III. Mënyra e aplikimit:

Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në DKA. Formulari i aplikimit merret/shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks-gov.net>

IV. Themelimi i marrëdhënies së punës:

Marrëdhënia e punës themelohet nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës.

V. Aplikimi në konkurs:

Afati i aplikimit fillon nga data 25.9.2023 dhe zgjat 8 ditë kalendarike, me datë 02.10.2023, deri në orën 16:00.